



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Prishtinë, 20 nëntor 2021

KOMUNIKATË PËR MEDA

Oda e Mjekëve të Kosovës ka filluar organizimin e procesit zgjedhor i cili rregullohet me akt të veçantë normativ siç është Kodi Zgjedhor i OMK-së dhe mbikëqyret nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pranë OMK-së, organ ky i zgjedhur nga Kuvendi i Odës.

Zgjedhjet e legjislaturës së III-të Kuvendit të Odës, janë zgjedhjet e para që nga themelimi i saj, në të cilat në bazë të Regjistrit të konsoliduar të anëtarësisë, të gjithë mjekëve u garantohet e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje, pa marr parasysh statusin e tyre të punësimit apo atë profesional.

E drejta për të zgjedhë dhe për tu zgjedhur, janë të drejtat themelore që janë të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionit në fuqi. Të drejtat të tilla janë të patjetërsueshme dhe të pa mohueshme, deri sa ato garantohen me ligj. Ky proces kompleks mund edhe të përcjellet me probleme dhe sfida sa i përket aspektit organizativ. Mirëpo në asnjë mënyrë nuk mund të tolerohet pengimi i ushtrimit të të drejtave të tilla nga ana e individëve, aq më shumë prej atyre që janë të mëveshur me përgjegjësi institucionale.

Së fundmi, KQZ-ja është vënë në dijeni se në disa institucione shëndetësore, madje në disa klinika të SHSKUK-së, menaxhmenti i këtyre institucioneve është duke e penguar procesin duke mos informuar në mënyrë të drejtë personelin mjekësor që janë anëtarë të Odës.

KQZ-ja i bënë thirrje të gjithë strukturës menaxhuese të sistemit shëndetësor që të shfaqin frymën bashkëpunuese duke ndihmuar organet e Odës për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Odës. Ndërkaq të gjithë anëtarëve që pamundësohet apo hasin në çfardo vështërsie lidhur me dorëzimin e aplikacioneve për kandidim për shkak të mosinformimit apo pengesave të ndryshme objektive, KQZ-ja i fton të njëjtit që ta njoftojnë këtë të fundit në mënyrë që të ndërmerren masat adekuate për tejkalimin e çfardo pengese dhe mundësimin e realizimit të të drejtave zgjedhore.

KQZ-ja po ashtu shfrytëzon rastin që t'i bëj thirrje të gjithë anëtarëve që për çdo informatë eventuale t'i drejtohen drejtpërdrejt KQZ-së dhe Sekretariatit të KQZ-së, duke shfrytëzuar kontaktet dhe adresën e selisë së Odës. KQZ-ja është i vetmi organ i cili ka kompetencë të plotë për të menaxhuar procesin zgjedhor dhe të sigurojë transparencë të plotë, gjithnjë duke respektuar detyrimet ligjore nga sfera e mbrojtjes të të dhënave personale.

Kryesues i KQZ-së së OMK-së

Dr. Adem Nura